



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë/a:	06.10.2021
Referenc-ë:	07-353/04-208486/21
Për/ Za/ To:	OJQ "Gora" - Sevdije Ramadani
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrollloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 07-07-353/04-208486/21 nga OJQ "Gora" me përfaqësuese Sevdije Ramadani me të cilën kërkohet që me datë 20-23 Tetor 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në sheshin Zahir Pajaziti".

Qëllimi i kërkesës është realizimi i ekspozitës të cilën e ka subvencionuar Komuna e Prishtinës gjegjësisht Drejtoria e Kulturës.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin OJQ "Gora" me përfaqësuese Sevdije Ramadani për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin "Zahir Pajaziri" me datë 20-23 Tetor 2021 për realizimin e ekspozitës në të cilën do të marrin pjesë shoqata me artizanale, ushqime tradicionale dhe prodhime vendore të cilën e ka subvencionuar Komuna e Prishtinës gjegjësisht Drejtoria e Kulturës.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHIP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

13-010-2021

Page 1 nga 1